

Analiza vjetore 2019

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

Në zbatim të Urdhrit nr. 6, të Kryetarit të KLSH-së, datë 23.01.2020, “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së departamenteve të KLSH-së për vitin 2019, në datën 31 janar 2019 Drejtoria e auditimit të Brendshëm në KLSH kreu analizën e veprimtarisë së saj për vitin që lamë pas. Raporti u fokusua në drejtimet e mëposhtme:

Së pari, ai paraqiti përgjegjshmërinë e realizimit të programit të auditimiti dhe trajtoi menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale të auditimit të brendshëm.

Së dyti, me anë të tij u komunikuan rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm duke pasquruar problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara në secilin mision auditimi.

Misioni i Auditimit të Brendshëm.



Auditimi i Brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka për mision të japë siguri objektive dhe të ofrojë këshillim për menaxhimin për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e KLSH-së. Auditimi i Brendshëm ndihmon KLSH-në për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

DAB në KLSH ka kryer veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe akteve të tjera të dala në zbatim dhe plotësim të kuadrit

ligjor për veprimtarinë e AB, të cilat përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka funksionuar si Drejtori në varësi të Kryetarit të KLSH sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 4, datë 27.01.2017 “Mbi miratimin e strukturës organizative të Kontrollit të Lartë të Shtetit, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave” i ndryshuar dhe përbëhet nga 5 punonjës sipas skemës 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë auditues.

Anëtarët e DAB kanë arsim të lartë për shkencë ekonomike dhe juridike dhe kanë ndjekur procesin e trajnimit vjetor prej 40 orësh, të organizuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm i miratuar nga Kryetari i KLSH me shkresën nr. 1467 prot., datë 31.12.2018, ku janë planifikuar 5 misione auditimi me bazë sistemi. Llogaritja për numrin e planifikimit të misioneve të auditimit është bërë duke patur parasysh strukturën me burimet njerëzore të DAB. Për periudhën raportuese janë planifikuar 5 misione auditimi me bazë sistemi dhe janë realizuar 4 të tilla. Më konkretisht:

1. Auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” për vitin 2018 në Kontrollin e lartë të Shtetit. *Në përfundim të këtij auditimi është konkluduar në dy gjetje të cilat kanë rezultuar të rëndësishme së ulët për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse në Raportin Final të auditimit.*
2. Auditimi "Mbi auditimin e përputhshmërisë për menaxhimin e sistemit të burimeve njerëzore". *Auditimi ka përfunduar. Gjatë fazës audituese u konstatuan 2 gjetje të cilat janë të rëndësishme së mesme dhe për ato u lanë dhe rekomandimet përkatëse në Raportin Final.*
3. Auditimin “Mbi sistemet e strukturës në implementimin e projektit IPA 2013, “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri”, në KLSH. *Auditimi ka përfunduar. Gjatë auditimit nuk janë vërejtur parregullsi në lidhje me krijimin dhe funksionimin e sistemeve, për rrjedhojë nuk ka patur rekomandime.*
4. Me Urdhër të kryetarit të KLSH u ngrit një grup për të kryer verifikimin i veprimtarisë së Departamentit Juridik për periudhën 01/10/2018 deri në 15/09/2019. *Grupi në përfundim të punës ka përgatitur Raportin i cili i është adresuar Kryetarit të KLSH si dhe Sekretarit të Përgjithshëm së bashku me sugjerimet për korigjimin e problematikës së vërejtur dhe përmirësimit të situatës.*

Përveç misioneve të auditimit me bazë sistemi, DAB në zbatim të kapitulli IV, pika 4.1.13 të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ka kërkuar informacion mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe për të cilat është rënë dakord, sipas afateve të përcaktuara në plan veprimet e dakordësuara më parë me subjektet e audituara dhe nivelin e lartë menaxherial. Vlen të theksohet se bashkëpunimi dhe gadishmëria për implementimin e rekomandimeve të lëna ka qenë e kënaqshme.

Misioni i auditimit të institucionit të KLSH, “Për auditimin e sistemit, përputhshmërisë në fushën e menaxhimit financiar” për vitin 2019, është në proces.

Gjatë vitit 2019 ka përfunduar dhe 1 mision auditimi i deklaruar në proces në raportin për veprimtarinë e vitit 2018.

Për të rritur cilësinë e auditimeve në vitin 2019 është kryer në vazhdimësi rishikimi i punës së audituesve. Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, rishikimi dhe vlerësimi i cilësisë për materialet e auditimit (raportet paraprake, raportet finale, memo etj) është realizuar gjatë procesit të auditimit, nga përgjegjësi i grupit dhe Drejtori i Drejtorisë. Megjithatë duhet pranuar se në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të zbatimit të standardeve të auditimit, gjithnjë ka vend për përmirësim.

Nga drejtuesi është bërë rishikimi i cilësisë duke bërë shqyrtimin e raporteve të auditimit dhe dokumenteve të tjera të administruara në secilën dosje të auditimit.

Për vitin 2020 DAB ka planifikuar të kryejë 5 misione auditimi në subjektet e mëposhtëm:

Departamenti Juridik; Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore; Departamenti i Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore; Sektori i Shërbimeve në Drejtorinë e IT dhe Logjistikës dhe Sektori i Financës. Gjithësesi ky plan është fleksibël dhe mund të ndryshojë në varësi të nevojave dhe kërkesave të Kryetarit të institucionit për tu angazhuar në misione auditimi ku do të shihet e nevojshme.